



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
DRERJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE
SEKTORI PERSONELIT

NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PUNE

Në zbatim të ligjit nr. 8224 datë 15.05.1997 ndryshuar me ligjin 8335 datë 23.04.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe të Komunës”, VKM nr.313 datë 01.07.2002 “ Për caktimin e strukturës së numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të Policisë së Bashkisë dhe Komunës “ i ndryshuar, ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” , VKB nr. 158 datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2022”, si dhe në urdhërin nr.550 prot.8874 datë 02.11.2022 ”Njoftim për vende të lira pune”, Bashkia Durrës shpall konkurimin për vende të lira pune në pozicionin :

1.Polic pranë Policisë Bashkiake (8 pozicione)

Kërkesa të vecanta për kandidatët :

- Të ketë arsim të mesëm ose të lartë
- Të jetë në mosheë 19 – 27 vjeç
- Të ketë të paktën 3 vjet eksperience pune
- Të ketë aftësi të punës në grup, aftësi gjyqese dhe të kontrolloj situata të krijuara të paparashikuara.
- Të ketë aftësi të mira fizike dhe gjatësi trupore 1.75 cm
- Të ketë njohuri mbi programet bazë të kompjuterit.
- Preferohet të ketë punuar në policinë e shtetit

Përshkrimi specifik i punës për pozicionin Polic pranë Sektorit të Policise Bashkiake : Të zbatojë Urdhërat e nxjerra nga Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak, të kontrollojë në zona të caktuara nga Bashkia dhe të bëjë konstatimin e parandalimin e shkeljeve administrative duke vepruar konform ligjit, të marrë masa për ruajtjen e pasurisë së Bashkisë si dhe atyre që administrohen prej saj, të marrë masa për ruajtjen e rendit kur ka grumbullime njerëzish, të inspektojë tregjet, të kontrollojë zënien e vendeve për tregti ambulante.

Literatura : Ligji nr. 8224 datë 15.05.1997 ndryshuar me ligjin 8335 datë 23.04.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe të Komunës”, VKM nr.313 datë 01.07.2002 “ Për caktimin e strukturës së numrit të punonjësve dhe shpenzimeve buxhetore të Policisë së Bashkisë dhe Komunës “ i ndryshuar, Kandidati duhet të paraqes brenda datës 11.11.2022 në Drejtorine e Burimeve Njerëzore këto dokumenta :

1. Kërkesën për aplikim
2. Jetëshkrim
3. Fotokopje të Dëftesës të noterizuar ose të diplomës
4. Fotokopje të librezës punës
5. Dëshmi kualifikimi për kompjuterin
6. Vlerësim pune nga punëdhënësi i mëparshëm
7. Fotokopje e kartës së identitetit.
8. Dëshmi e gjendjes gjyqësore.

Pas verifikimit paraprak më datë 14.11.2022 në Bashki do të shpallet lista e aplikantëve që plotësojnë kushtet për testim.